



QYTETARI NË
REND TË PARË

ANALIZË KRAHASUESE



E PRAKTIKAVE MË TË MIRA
PËR TË DHËNAT E HAPURA
NË BASHKIMIN EVROPIAN



Projekt i financuar nga Bashkimi Evropian
dhe i ko-financuar nga Ambasada Britanike



ALKA



ANALIZË KRAHASUESE E PRAKTIKAVE MË TË MIRA PËR TË DHËNAT E HAPURA NË BASHKIMIN EVROPIAN

PROJEKTI “QYTETARI NË REND TË PARË”

qershor, 2016

ANALIZË KRAHASUESE E PRAKTIKAVE MË TË MIRA PËR TË DHËNAT E HAPURA NË BASHKIMIN EVROPIAN

Botues: Qendra për Administrim me Ndryshime

Për botuesin: Neda Maleska Saçmaroska, Qendra për Administrim me Ndryshime

Autorë: Martin Todevski

Redaktorë: Martin Todevski

Përktheu: AD VERBUM Shkup

Disenji dhe shtypi: Brigada dizajn

Tirazhi: 350 ekzemplarë (Tirazh falas/jokomercial)

CIP - Каталогизacija во публикаcija

Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

352:061.2(497.7)

ANALIZË krahasuese e praktikave më të mira për të dhënat e hapura në bashkimin Evropian. - Shkup : Qendra për administrim me ndryshime, 2016. - 36 стр. : граф. прикази ; 24 см Публикацијата е во рамките на проектот: “Qytetari në rend të parë”. - Библиографија: стр. 34-35

ISBN 978-608-65603-9-3

а) Локална самоуправа - Невладини организации - Соработка - Македонија б) Локална самоуправа - Транспарентност - Отворени податоци - Македонија

COBISS.MK-ID 101818378

Projekt “Qytetari në rend të parë” i implementuar nga Qendra për Administrim me Ndryshime dhe Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm ALKA, financuar nga Unioni Evropian dhe i kofinancuar nga Ambasada Britanike në Shkup.



Ky publikim është përgaditur me ndihmën e Unionit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se reflekton opinionin e Unionit Evropian.



Ambasada Britanike Shkup mbështeti përgatitjen e këtij publikimi, brenda projektit “Qytetari në rend të parë”. Përmbajtja e këtij botimi nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimin apo mendimet e Ambasadës Britanike.

PËRMBAJTJA

1. Hyrje	5
2. Çfarë janë të dhënat e hapura?	7
3. Baza për analizën krahasuese	8
4. Analiza krahasuese	9
4.1. Portali evropian për të dhëna të hapura	9
4.2. Britania e Madhe	10
4.2.1. Këshilli i qytetit të Bristolit: “Ngjallja e të dhënave të hapura“	11
4.2.2. Redbridge Data Share	12
4.2.3. Leeds Data Mill	13
4.2.4. Platforma për shpenzime e Këshillit të Norfolk County	14
4.2.5. Portali për informata dhe turizëm i North Somerset	15
4.3. Danimarka	16
4.3.1. Open Data DK	16
4.3.2. Know your waste	17
4.3.3. Komunikacioni në Aarhus	18
4.4. Finlanda	19
4.4.1. Të dhëna të hapura në Helsinki	19
4.4.2. Shembuj të aplikacioneve të suksesshme nga Helsinki	20

4.5. Holanda	22
4.5.1. 10.000scholen.nl	22
4.5.2. VaarWater	23
4.5.3. Omgevingsalert	23
4.5.4. ZonAtlas	23
4.6. Franca	24
4.6.1. Oficeri kryesor për të dhëna	24
4.6.2. Të dhëna të hapura të SNCF	24
4.7 Austria	26
4.7.1. Modeli për implementimin e Qeverisë së Hapur	26
4.7.2. Portali për të dhëna të hapura të Vjenës	28
4.7.3. Harta e toaleteve të Vjenës	29
4.7.4. Parkingu në Vjenë	29
4.7.5. Buxheti i hapur	30
5. Përfundim - rekomandime	31
6. Literatura e shfrytëzuar	34

1. HYRJE

Projekti “**Qytetari në rend të parë**” e realizoi organizata qytetare “Qendra për menaxhim me ndryshime” në partneritet me “Qendrën për zhvillim të qëndrueshëm ALKA”. Projekti është mbështetur nga ana e Delegacionit të Bashkimit Evropian përmes Sektorit për financim qendror dhe lidhjen e marrëveshjeve (CFCD) në suaza të Ministrisë së Financave, në kuadër të komponentit për përmirësimin e inkuadrimin të shoqërisë civile në krijimin e mendimit publik, politikave dhe vendimmarrje në nivel nacional dhe lokal.

Projekti është fokusuar në përmirësimin e transparencës së autoriteteve lokale përmes vendosjes së standardeve për të dhëna të hapura dhe të mençura në nivel lokal, me qëllim të inkuadrimin më të mirë të qytetarëve dhe organizatave qytetare në ndjekjen e punës dhe vendimmarrje nga ana e komunave. Projekti zbatohet në **8 qendrat urbane të vendit**: Shkup, Manastir, Veles, Kumanovë, Strumicë, Tetovë dhe Shtip.

Projekti është në pajtim me iniciativën globale për **Partneritet të hapur qeveritar**, ndaj së cilës Qeveria e RM-së u inkuadrua në vitin 2011, ndërsa është bazuar në projektin “Të dhëna të hapura” të Ministrisë për Shoqëri Informatike dhe Administratë, ku janë përfshirë institucionet qendrore qeveritare.

Aktivitetet e projektit janë:

- Përpunimi i drejtimeve për të dhëna të hapura të njësive të vetëqeverisjes lokale, në bashkëpunim me organizatat qytetare, institucionet qendrore dhe lokale;
- Përmirësimi i kapaciteteve të organizatave qytetare përmes trajnimeve për të kuptuar dhe shfrytëzimin e informatave të prezantuara dhe të dhënat e hapura e njësive të vetëqeverisjes lokale;
- Vendosija dhe përmirësimi i komunikimit strukturor dhe bashkëpunimi në bazë të rregullt mes njësive të vetëqeverisjes lokale, organizatave lokale qytetare dhe institucioneve shtetërore – Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë (MSHIA), Ministria për Vetëqeverisje Lokale (MVL), përmes partneriteteve rrjetë të cilat shërbejnë për shkëmbimin e njohurive dhe përvojave;
- Rritja e vetëdijes për nevojën nga të dhënat e hapura dhe të mençura të njësive të vetëqeverisjes lokale.

Një nga komponentët e projektit është zbatimi i analizës krahasuese të praktikave më të mira për të dhëna të hapura në Bashkimin Evropian. Kjo analizë, bashkë me analizën e zbatuar të qytetarëve dhe fokus grupet e organizuara në 8 qendrat urbane në vend për nevojat e qytetarëve nga të dhënat dhe informatat nga ana e autoriteteve lokale, do të shërbejë si input i rëndësishëm në përpunimin e drejtimeve për të dhënat e hapura sipas të cilave duhet të udhëhiqen komunat.

Drejtimet për të dhënat e hapura është e nevojshme t'i definojnë të gjitha setet e të dhënave të cilat do të duhej të publikohen nga ana e komunave në formë të dhënave të hapura. Sipas kësaj, qëllimi i analizës krahasuese, është që krahas nevojave të caktuara të qytetarëve për të dhënat dhe informatat, të japë propozim si mund të aplikohen më së miri praktikat më të mira në nivel evropian lidhur me setet e caktuara të dhënave, mënyrën se si ato publikohen, ose mënyrën se si qaset në përgjithësi në politikën për të dhënat e hapura në vend.

2. Çfarë janë të dhënat e hapura?

Organizatave, e veçanërisht institucionet nga sektori publik, në suaza të kompetencave të tyre grumbullojnë numër të madh të dhënave. Një pjesë e madhe e të dhënave mund të publikohen, gjegjësisht të “hapen” në format të dhënave të hapura.

Sipas **definicionit**, të dhënat e hapura janë të dhëna në format që përpunohen me kompjuter, të cilat lirisht mund të përdoren, të ri-shfrytëzohen dhe të ri-distribuheshin nga ana e secilit, pa kufizime.

Pse hapja e të dhënave do të ishte me interes të dikujt?

Nëse i marrim parasysh institucionet e sektorit publik, do të mund të konstatojmë se ata në pajtim me kompetencat e tyre ligjore, si dhe në suaza të aktiviteteve të tyre të përditshme, grumbullojnë dhe përpunojnë numër të madh të dhënave, nga përfshirje e gjerë. Njëkohësisht, duke u nisur nga fakti se të gjitha këto të dhëna (të cilat nuk janë të dhëna personale, ose informata të kualifikuara), u takojnë të gjithë qytetarëve, pasi që me të hollat e qytetarëve financohet puna e institucioneve.

Në mënyrë plotësuese, të dhënat e kanë vlerën e tyre të rëndësishme. Nga njëra anë, publikimi i të dhënave për punën e institucioneve shtetërore veçanërisht në pjesën e punës financiare, kontribuojnë për rritjen e **transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve**.

Nga ana tjetër, të dhënat e publikuara e kanë edhe **potencialin e tyre ekonomike**. Në të vërtetë, rezultatet nga më shumë hulumtime tregojnë se vlera ekonomike e të dhënave të hapura kap vlerën e disa dhjetëra milionë euro në vjet vetëm në Bashkimin Evropian. Me të dhënat të cilat shfrytëzohen dhe ri-shfrytëzohen lirisht, qytetarët, kompanitë dhe organizatat e interesuara zhvillojnë prodhime dhe shërbime të reja, inovative përmes të cilave realizojnë profit. Në këtë dokument mund të gjenden më shumë shembuj për atë se si shfrytëzohen të dhënat e hapura nga ana e institucioneve shtetërore në vendet e BE.

Po ashtu, të dhënat e hapura shpijnë drejt **efikasitetit më të madh në punën e institucioneve shtetërore**. Vetë fakti se të gjithë, ose një pjesë e të dhënave të cilat i grumbullon institucioni janë të publikuara dhe të kapshme, rezulton me rënie të madhe të kërkesës për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik, për përpunimin e të cilave administrata duhet të investojë angazhimin e vet.

3. Baza për analizën krahasuese

Analiza krahasuese fokusohet në hulumtimin e politikave për të dhëna të hapura në disa vende evropiane të zgjedhura. Zgjedhja e vendeve evropiane ku do të hulumtohet është bërë në bazë të renditjes në Indeksin global për të dhëna të hapura për vitin 2015¹, i cili indeks përpunohet nga Open Knowledge International në bashkëpunim me vullnetarë nga Rrejtji i njohurive të hapura anembanë botës.

Indeksi global për të dhënat e hapura përpunohet në nivel vjetor, që të jepet vlerësimi për gjendjen e të dhënave të hapura qeveritare në vendet përkatëse. Në të vërtetë, kjo iniciativë ka për qëllim të sigurojë pasqyrë të shoqërisë civile rreth asaj se si qeveritë i publikojnë të dhënat, pasi që inputi jepet nga qytetari dhe organizatat anembanë botës, sipas metodologjisë së caktuar nga më parë.

Duk marrë parasysh se ky Indeks global përpunohet në nivel global, i njëjti mundëson zbatueshmi të rezultateve me kalimin e kohës, gjegjësisht progres i vendeve në implementimin e politikave të veta për të dhënat e hapura.

Sipas renditjes së bërë në vitin 2015, vendet më të mira në BE për të dhëna të hapura janë këto:

Vendi	Pozita globale	Rezultati
Britania e Madhe	2	76%
Danimarka	3	70%
Finlanda	5	67%
Holanda	8	64%
Franca	10	63%
Rumania	13	58%
Bullgaria	16	56%
Spanja	17	55%
Italia	17	55%
Çekia	21	52%

Analiza krahasuese do t'i përfshijë 5 vendet e para sipas renditjes së bërë, gjegjësisht Britaninë e Madhe, Danimarkën, Finlandën, Holandën dhe Francën. Krahas këtyre 5 vendeve, do të analizohet edhe gjendja në Austri, duke marrë parasysh bashkëpunimin intensiv të realizuar me KDZ Austri.

Po ashtu lëndë e analizës do të jetë edhe Portali evropian për të dhëna të hapura, ku në një vend mund të gjendet set i të dhënave të hapura të vendeve – anëtare të Bashkimit Evropian.

¹ <http://index.okfn.org/>

4. Analiza krahasuese

4.1. Portali evropian për të dhëna të hapura

Portali evropian për të dhëna të hapura (<http://www.europeandataportal.eu/>) është iniciativë e Komisionit Evropian si pjesë e tregut të vetëm digjital. Qëllimi i këtij portali është që në një vend t'i prezantojë të setet e hapura të dhënave nga 28 vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe 4 vendet anëtare të EFTA.

Portali është përpunuar për shkak të prezantimit më të thjeshtë dhe kërkimit të gjitha të dhënave të hapura të vendeve në këtë iniciativë. Portali prezanton meta të dhëna, gjegjësisht të dhëna përshkruese për vetë të dhënat dhe nuk bën ruajtjen e setit të dhënave në këtë portal. Meta të dhënat ndërmerren automatikisht (“harvestojnë”) nga portalet nacionale për të dhënat e hapura, ku setet e të dhënave në të vërtetë ruhen.



Fotografia 1 – Portali evropian për të dhëna të hapura

Me qëllim që automatikisht të ndërmerren meta të dhënat nga portalet nacionale për të dhënat e hapura, nevojitet që publikuesi i të dhënave të publikojë meta të dhëna për setet e të dhënave, dhe atë sipas standardeve të caktuara CKAN/INSPIRE/DCAT-AP, me reprezentim të meta të dhënave në XML/JSON. Në portal mund të gjenden udhëzime të hollësishme, të cilat mund t ndiqen edhe nga ana e publikuesve të dhënave në vendin tonë, për shkak të publikimit të tyre në të ardhmen dhe në portalin qendror të Bashkimit Evropian.


CKAN është platformë e kodit të hapur të dhënave, gjegjësisht zgjidhje softueri për publikim, shpërndarje, kërkim dhe shfrytëzim të dhënave. CKN e përdor modelin e vet për meta të dhëna, me ueb interfejs i cili u mundëson shfrytëzuesve të kërkojnë meta të dhëna.

INSPIRE (Infrastructure for Spatial Information in the European Community) paraqet iniciativë e Bashkimit Evropian për mundësimin e qasjes më të mirë dhe inter-operimit të informatave hapësinore dhe gjeografike. INSPIRE direktiva e BE ka për qëllim të vendos kornizë të përgjithshme për infrastrukturë për të dhëna hapësinore. Meta të dhënat të cilat kanë të bëjnë me të dhënat nga INSPIRE direktiva janë caktuar në Regullativën e Komisionit Evropian nr. 1205/2008 nga 3 dhjetori 2008 për implementimin e INSPIRE direktivës lidhur me meta të dhënat.

DCAT-AP (DCAT Application profile for data portals in Europe) është standard për meta të dhëna të bazuar në DCAT (Data Catalogue vocabulary) për përshkrimin e setit të dhënave nga sektori publik në Evropë. Përdoret nga ana e Portalit evropian për të dhëna të hapura si vokabular i përbashkët për harmonizimin e përshkrimeve të më shumë se mijë seteve të dhënave të cilat ndërmerren automatikisht nga një numër i madh i portaleve nacionale të vendeve – anëtare.

4.2. Britania e Madhe

Pas një sërë fushatash nga organizata të ndryshme të orientuara drejt Qeverisë së Britanisë së Madhe me qëllim që t'i "lirtojë" të dhënat publike për qytetarët, në vitin 2000 u vendos portali qendror për të dhëna të hapura të Britanisë së Madhe data.gov.uk. Krahas portalit u vendos licenca për qeveri të hapur, me të cilën u mundësia që të dhënat lirish dhe pa pagesë të shfrytëzohen dhe të ri-distribuheshin. Në këtë portal janë publikuar mijëra sete të dhënash nga institucionet britanike.



Fotografia 2 – Portali për të dhëna të hapura të Britanisë së Madhe data.gov.uk

Analiza e përgatitur e Deloitte² për Shakespeare Review of Public Sector Information jep vlerësim se përfitimet ekonomike nga informatat e publikuara nga sektori publik për Britaninë e Madhe janë rreth 1,8 miliardë paund, me përfitime sociale prej rreth 5 milionë miliardë paund.

² "Market Assessment of Public Sector Information", Deloitte, May 2013, https://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/198905/bis-13-743-marketassessment-of-public-sector-information.pdf

Me ndryshimet e Ligjit për liri të informatave përmes Ligjit për mbrojtje të lirive në vitin 2012 ndryshon/plotësohet e drejta për qasje deri te informatat me karakter publik, në të drejtën për ri-shfrytëzimin e këtyre informatave. Kjo do të thotë se të gjitha të dhënat të cilat nuk janë përjashtuar nga ligji për lirinë e informatave duhet të bëhen të kapshme si të dhëna të hapura.

Britania e Madhe vendos qasje interesante në promovimin e transparencës lokale, përmes vendosjes së **Kodit për transparencë të autoriteteve lokale**, përmes të cilave ngarkohen autoritetet lokale të publikojnë numër të madh të seteve të dhënave të hapura, duke përfshirë të dhëna për shpenzimet buxhetore (mbi 500 paund) dhe marrëveshjet e lidhura, rrogat për pozitat udhëheqëse, grantet e dhëna, prona publike dhe dokumenti pronor, si dhe informata tjera. Kodi parasheh sete të dhëna të obligueshme të cilat duhet të publikohen në periudhë tremujore, periudhë vjetore, sete të dhënash të cilat duhet të publikohen vetëm një herë. Po ashtu janë paraparë edhe sete të dhënash për të cilat rekomandohet të publikohen nga ana e autoriteteve lokale, por nuk janë të obligueshme.

Në vazhdim e sipër janë prezantuar disa nga **praktikat më të mira të autoriteteve lokale në Britaninë e Madhe**, lidhur me promovimin dhe shfrytëzimin e të dhënave të hapura:

4.2.1. Këshilli i qytetit të Bristolit: “Ngjallja e të dhënave të hapura“

Këshilli i qytetit të Bristolit investon shumë përpjekje në rritjen e transparencës të vet përmes shfrytëzimit të përfitimeve nga teknologjitë digjitale. Krahas aktiviteteve për grumbullimin dhe publikimin e të dhënave në format të hapur, Këshilli vendos iniciativë për promovimin e potencialit nga të dhënat e hapura, përmes publikimit të garës (“**B-Open**”), ku janë ftuar kompani dhe organizata të marrin pjesë me idetë e tyre për shfrytëzimin e të dhënave të hapura për përpunimin e aplikacioneve, ueb faqeve, shërbimeve mobile etj. Si rezultat i garës, është mundësuar financimi i tre projekteve fituese: “**Blossom Bristol**” – loja për celularë, ku pjesëmarrësit mund të mbjellin bimë virtuale në qytet dhe të ndjekin nëse do të zhvillohen varësisht nga faktorët real të mjedisit jetësor në qytet; “**Hills are Evil**” – hartë dinamike e cila u ndihmon personave me lëvizshmëri të kufizuar ta gjejnë rutën më të mirë mes dy vendeve “**I Love My City**” – paraqitja e shpenzimeve në hiper-nivel lokal.



Fotografia 3- Loja për celularë
“Blossom Bristol”
Burimi: Google Play Market

4.2.2. Redbridge DataShare

London Borough of Redbridge është një nga këshillat e para me iniciativë të tillë që t'i publikojë të gjitha setet e të dhënave të mundshme në cilindo vend. Megjithatë, mundësia që të gjitha këto të dhëna të jenë të centralizuara në një vend, do të thotë shumë për qytetarët nga aspekti i gjetjes më të lehtë të dhënave të nevojshme, shfrytëzimi i tyre dhe kombinimi me të dhëna të tjera.

Për këtë qëllim, kanë zhvilluar **platformë qendrore për publikimin e setit të dhënave** (<http://data.redbridge.gov.uk/>), ku në mënyrë të thjeshtë janë prezantuar të dhënat e hapura për çdo shërbim të këshillës, ndërsa të dhënat janë publikuar sipas kontekstit, gjegjësisht sipas shërbimit, informatave financiare dhe demokracisë. Shfrytëzuesit mund të kërkojnë të dhëna, t'i lidhin, ti gjejnë në hartë dhe t'i vizualizojnë të dhënat në formate të ndryshme, siç janë tabelat, hartat, grafikët etj., si dhe t'i ndërmarrin të dhënat dhe t'i shfrytëzojnë për qëllime të tyre. Me rëndësi të veçantë është mundësia që të dhënat të kontrollohen në nivel të ndryshëm të detajeve dhe të njëjtat mund të kombinohen me burime tjera të dhënave.




Fotografia 4 – data.redbridge.gov.uk

4.2.3. Leeds Data Mill

Platforma **Leeds Data Mill** u publikua në mars të vitit 2014, si platformë e centralizuar për publikim dhe stimulim të shfrytëzimit të dhënave të hapura nga këshilli i Lidsit dhe organizatat tjera të jashtme, me qëllim të stimulimit të bashkëpunimit, inovacionit dhe inkuadrimit. Platforma është përgatitur duke shfrytëzuar teknologjitë e kodit të hapur të bazuar në SKAN.

Platforma ofron interfejs i cili është i thjeshtë për përdorim duke mundësuar dorëzimin e kërkesave për sete të reja të dhënave, duke mbështetur blogje, projekte dhe përfshirje të bashkësisë. Aspekti specifik i këtij portali është mundësia që përdoruesit të krijojnë vizuelizim dhe “tregime” të dhënave të hapura, të cilat mund të publikohen dhe të ndahen me përdoruesit e tjerë. Po ashtu, është dhënë mundësia që shfrytëzuesit t'i personalizojnë të dhënat sipas interesave të tyre, qoftë kjo të jetë e lidhur me punën, rekreacionin ose aktivitetet sociale.




Fotografia 5 - Leeds Data Mill - leedsdatamill.org

4.2.4. Platforma për shpenzime e Këshillit të Norfolk County

të vërtetë, në pajtim me Kodin për transparencë të pushteteve lokale, edhe më parë Këshilli ka publikuar të dhëna për shpenzimet, furnizimet dhe marrëveshjet e lidhura, që paraqet obligim të domosdoshëm sipas këtij akti. Megjithatë, duke marrë parasysh numrin e madh të kërkesave të fituara për qasje deri te informatat me karakter publik, është vërtetuar nevoja për prezantim më të thjeshtë të këtyre të dhënave në formë që kuptohet lehtë nga ana e shfrytëzuesve.

Sipas kësaj, kjo platformë ofron mundësi për prezantim interaktiv të dhënave nga shpenzimi i pushtetit lokal, duke i kategorizuar sipas fushës së furnizimit, tipit të furnitorit, shërbimit dhe marrëveshjet të cilat skadojnë. Krahas vizuelizimit, për kontroll të hollësishtëm janë të kapshme edhe tabelat e të dhënave.



Fotografia 6 – Platforma për shpenzime e Këshillit të Norfolk County

4.2.5. Portali për informata dhe turizëm i North Somerset

North Somerset gjendet në pjesën jug-perëndimore të Anglisë dhe turizmi për atë është kontribuues shumë i rëndësishëm për ekonominë lokale.

Ky pushtet lokal tashmë e shfrytëzon Datashare platformën³ për publikimin e një numri të madh të dhënave në format të hapur. Por, këshilli e ka parë mundësinë se në mënyrë plotësuese mund t'i shfrytëzojnë mundësitë e t dhënave të hapura që të krijojnë ueb portal ku mund ta promovojnë turizmin në komunë, me qëllim që ta rritin ofertën, por edhe numrin e turistëve dhe gjatësinë e vizitave turistike.

Përfaqësues të këshillit kanë qenë të inkuadruar në identifikimin e seteve të dhënave, të cilat duet të shfrytëzohen, si dhe në marrjen e të dhënave plotësuese multimediale për pasurimin e përmbajtjeve.

Pas publikimit të portalit⁴, i njëjti përjeton sukses të madh sipas numrit të vizitave në portal, por edhe sipas numrit të rritur evident të turistëve dhe gjatësisë së vizitave turistike.



Fotografia 7 – Portali për turizëm i North Somerset

³ <http://data.n-somerset.gov.uk/>

⁴ <http://discovernorthsomerset.co.uk/>

4.3. Danimarka

Iniciativa për të dhëna të hapura në Danimarkë zhvillohet si rezultat i bashkëpunimit mes organizatës që i bashkon pushtetet lokale në Danimarkë “Local Government Denmark” dhe Qeveria e Danimarkës, me qëllim të përmirësimit dhe lidhjes së regjistrave publik të dhënave themelore që më vonë të njëjtat të bëhen të kapshme. Këta regjistra themelor janë të dhëna themelor që përdoren në sektorin publik siç janë adresat, kompanitë e regjistruara, informatat e kadastrit etj. Lidhshmëria mes regjistrave i zvogëlon shpenzimet për shkëmbim të informatave dhe dokumenteve mes regjistrave i zvogëlon shpenzimet për shkëmbim të dhënave dhe dokumentet mes institucioneve, por ua shkurton kohën e qytetarëve pasi që vetëm një herë i siguron të dhënat e tyre.


Duke marrë parasysh se si rezultat i kësaj iniciative, të dhënat nga regjistrat themelor sigurohen pa pagesë për qytetarët, dhe të njëjtat mund të ri-shfrytëzohen lirisht, ndërsa shpenzimet për kompanie zvogëlohen pasi që paraprakisht këto të dhëna i kanë “blerë” nga institucionet. Qëllimi përfundimtar i kësaj iniciative është që përmes publikimit të dhënave të hapura të stimulohet krijimi i tipave të ri të zgjidhjeve digjitale dhe shërbimeve të cilat kanë potencial ekonomik pozitiv për shoqërinë si tërësi.

4.3.1. Open Data DK

Portali për të dhënat e hapura i Danimarkës <http://www.opendata.dk/> është rezultat i bashkëpunimit mes komunave Aalborg, Aarhus, Vejle, Odense, Copenhagen dhe regjionit Midtjylland, me qëllim që në një vend mund të gjenden sete të hapura të dhënave nga komunat.

Pushtetet lokale në Danimarkë janë përgjegjëse për publikimin e të dhënave të hapura të portaleve të hapura të tyre, por portali qendror i grumbullon të dhënat e tyre të hapura, që t'i prezantojë të gjitha në një vend.

Portali qendror i Danimarkës është bazuar në SKAN platformën.



Fotografia 8 – Portali qendror për të dhëna të hapura i Danimarkës

Krahas këtij portali, ka iniciativa tjera për publikimin e të dhënave në nivel lokal, siç është **portali për të dhëna të hapura i Kopenhagës**⁵ ose **portali për të dhëna të hapura të Aarhus**⁶. Po ashtu, janë të kapshëm më tepër portale ku janë publikuar të dhëna të hapura nga institucionet qendrore, siç janë:

- Virk.dk – Portali për të dhëna për kompanitë në Danimarkë
- Portali për mjedis jetësor⁷- përmban të dhëna për cilësinë e ujit, ndotjes së tokës, bujqësinë etj.
- Agjencia për gjeo-të dhënat⁸- publikon të dhëna hapësinore, siç janë hartat themelore, hartat topografike etj.
- Portali Folketing⁹ – janë të kapshme të dhënat për deputetët dhe punën e Parlamentit

Në vazhdim janë prezantuar disa raste të suksesshme të shfrytëzimit të dhënave të hapura të publikuara nga ana e pushteteve lokale në Danimarkë.

4.3.2. Know your waste

Përmes këtij aplikacioni¹⁰ mund të fitohet fotografi e plotë për sasinë e mbeturinave në komunën e Aarhus, duke i përfshirë shërbimet për hedhjen e mbeturinave, gjegjësisht caktimin e kohës dhe pikat e grumbullimit të mbeturinave.

Shfrytëzuesi e shënon adresën e tij të banimit që të fitoje shërbime të personalizuara për pikën më të afërt për grumbullimin e mbeturinave, duke përfshirë shërbimet për riciklimin e mbeturinave.

Po ashtu, aplikacioni jep mundësi që të shihet sa kilogram mbeturina riciklohen në regjione të ndryshme në komunë.

⁵ <http://data.kk.dk/>

⁶ <http://www.odaa.dk>

⁷ <http://www.miljoportal.dk/borger/Sider/Borger.aspx>

⁸ <http://gst.dk/>


⁹ <http://www.ft.dk/aabnedata>

¹⁰ <http://genbrug.smartaarhus.dk/>

ANALIZË KRAHASUESE E PRAKTIKAVE MË TË MIRA PËR TË DHËNAT E HAPURA NË BASHKIMIN EVROPIAN

Vælg, hvor du bor i Aarhus Kommune og få info om dine nærmeste genbrugsstationer

Vil du udfylde en søjle af de mest almindelige fraktioner fra genbrugsstationerne i 2014? Her kan du se, hvor mange kilo affald der leveres på genbrugsstationerne i dit område baseret på måneder i 2014. Den vinklede cirkel repræsenterer den samlede mængde affald den pågældende måned. De mindre cirkler repræsenterer hver sin fraktion. Klik på et postnummer eller betryk musen over de forskellige elementer for at udføre visualiseringer. Klik på samme postnummer for at zoome ud.



Fotografia 9 – Aplikacioni Know Your Waste

4.3.3. Komunikacioni në Aarhus



Fotografia 10 – Harta për komunikacion në Aarhus

Ky aplikacion¹¹ tregon se sa shpejtë lëvizin automjetet në Aarhus. Aplikacioni është bazuar në OpenStreetMap dhe të dhënat për komunikacionin në kohë reale, të cilat merren si të dhëna të hapura nga portali për të dhëna të hapura në Aarhus www.odaa.dk.


Në Hartë janë shfaqur rrugët me linja me ngjyra të ndryshme varësisht nga dendësia e komunikacionit.

¹¹ <http://stiften.dk/trafikkort>

4.4. Finlanda

Në fillim të vitit 2013, është publikuar Programi për të dhëna të hapura të Finlandës 2013-2015 nga ana e Ministrisë së Financave të Finlandës, me qëllim që të katalizohet procesi i hapjes së të dhënave nga sektori publik. Programi bazohet mbi bashkëpunimin mes ministrive, institucioneve qeveritare, njësive të vetëqeverisjes lokale, instituteve hulumtuese dhe bashkësive programore.

Një nga rezultatet kryesore të programit është **portali për të dhëna të hapura dhe interoperabilitet** të Finlandës avoindata.fi, i cili është lëshuar në përdorim në shtator të vitit 2014. Është vendosur licenca nacionale për shfrytëzimin e të dhënave të hapura, Janë organizuar më shumë ngjarje lidhur me promovimin e të dhënave të hapura, ndërsa është vendosur edhe bashkëpunimi ndërkombëtar me institucionet evropiane.



Fotografia 11 – Portali nacional për të dhëna të hapura të Finlandës avoindata.fi

Në portalin nacional për të dhëna të hapura janë publikuar më shumë se 1400 sete të dhënash prej institucioneve të ndryshme.

4.4.1. Të dhëna të hapura në Helsinki

Qyteti i Helsinkit në bashkëpunim me tre qytete fqinje krijonjë **iniciativë regjionale “Infoshare”** të regjionit të Helsinkit. Përmes kësaj iniciative të dhënat nga këto komuna standardizohen dhe agregohen, duke mundësuar madhësi regjionale të dhënave. Nga ana tjetër, përmes portalit i cili është rezultat i kësaj iniciative <http://www.hri.fi/en/> këto të dhëna bëhen të hapura dhe të kapshme për qytetarët. Gjatë katër viteve prej fillimit të funksionimit të këtij portal, më shumë se 1000 sete të dhënash janë publikuar në këtë portal.



Fotografia 12 – Portali për të dhëna të hapura të rajonit të Helsinkit

Sasinë dhe përfshirjen e seteve të dhënave të publikuara e bën qyteti i Helsinkit, një nga liderët në fushën e të dhënave të hapura në nivel lokal. Si përkrahje e suksesit të kësaj iniciative është fakti se i njëjti ka fituar çmim nga Komisioni Evropian për inovacion në administratën publike.

Të dhënat e publikuara do të thotë transparencë më e madhe për komunat, por edhe efekt ekonomik pozitiv në zhvillimin e bizneseve të vogla të programerëve, të cilët i shfrytëzojnë këto të dhëna që të krijojnë prodhimeve dhe shërbime të ndryshme.

Disa nga shembujt pozitiv për shfrytëzimin e të dhënave nga portali janë këto që vijojnë:

4.4.2. Shembuj të aplikacioneve të suksesshme nga Helsinki

- **Aplikacion për celular për punën e Këshillit të Helsinkit**, i cili është bazuar në të dhënat e hapura për punën e Këshillit¹², siç janë agjendat e mbledhjeve, proces verbalet, vendimet, etj.

¹² <http://dev.hel.fi/apis/openahjo/>

- **Aplikacion për celular BlindSquare**¹³, i cili u ndihmon të verbërve të lëvizin nëpër qytet. Aplikacioni është bazuar në të dhënat e hapura për transport publik dhe të njëjtat kombinohen me të dhënat për lokacion nga rrjeti social Foursquare, si dhe veglat për vendndodhje, GPS dhe të folurit artificial e telefonave të mençur. Prodhimet tani funksionojnë në më shumë vende dhe gjuhë, dhe shitet rreth 17 EUR.



Fotografia 13 – Aplikacioni për celular BlindSquare

- **Helsinki më parë** – Aplikacioni e tregon historinë e Helsinkit përmes fotografive, videove dhe hartave. Janë publikuar fotografi të bëra nga e kaluara në vitin 1930, e këtij, me çka mund të shihet si është zhvilluar qyteti gjatë këtyre viteve.



Fotografia 14 – Aplikacioni “Helsinki më parë”

¹³ <http://blindsquare.com/>

4.5. Holanda


Holanda fillon me implementimin e politikave për të dhëna të hapura më vonë nga liderët botëror siç janë SHBA-të dhe Britania e Madhe. Megjithatë gjatë disa viteve të fundit, në **Portalin qendror për të dhëna të hapura të Holandës** data.overheid.nl janë publikuar një numër i madh i seteve të dhënave të rëndësishme.

Në vazhdim janë disa nga shembujt më interesant të aplikacioneve të cilat i përdorin të dhënat e hapura në Holandë.

4.5.1. 10.000scholen.nl

Në këtë aplikacion janë shfaqur **të gjitha shkollat fillore dhe të mesme në Holandë** me servis të mundësuar për krahasimin e tyre në bazë të parametrave të ndryshëm, siç janë lokacioni, numri i nxënësve (duke përfshirë nxënësit me nevoja të veçanta) në trendin kohor, struktura e nxënësve sipas moshës, madhësisë klasave, numrit të profesorëve (duke përfshirë të dhëna edhe për gjininë e profesorëve), ku mësojnë më shumë nxënës pas përfundimit të shkollës, rezultate nga auditi i jashtëm i shkollës etj.

Burimi i të dhënave për këtë aplikacion është Ministria e Arsimit të Holandës dhe institucione tjera shtetërore, ndërsa aplikacioni i ri-agregon këto të dhëna që t'i bëjë të mundshëm serviset.



Fotografia 15 - 10.000scholen.nl

4.5.2. VaarWater

VaarWater është aplikacioni i cili u shërben qytetarëve / vizitorëve në Amsterdam ta gjejnë rutën më të mirë nëpër kanalet në Amsterdam. Aplikacioni tregon më shumë se 1400 vende në dhe jashtë Amsterdimit të cilat janë me interes për t'u vizituar nëpër kanale.

Po ashtu, aplikacioni ofron informacione të dobishme, siç janë koha e hapjes së urave, nëse ka bllokada në kanale, ose lajme për motin.



Fotografia 16 - Aplikacioni VaarWater

4.5.3. OmgevingsAlert

Përmes këtij aplikacioni, shfrytëzuesi mund të informohet për të gjitha lejet të cilat i janë dhënë atij (adresa e tij) ose adresa afër vendit të tij të banimit. Në këtë mënyrë, mund të informohet për ngjarje të ndryshme në fqinjësi të cilat mund të ndikojnë mbi rrethinën e tij, siç janë hapja e dritareve plotësuese të fqinjtit, prerja e druve, vendosja e bilbordeve në rrethinë, etj.



Слика 17 - Aplikacioni OmgevingsAlert

4.5.4. ZonAtlas

Aplikacioni **ZonAtlas** i tregon të gjitha mundësitë dhe adekuate për gjenerimin e energjisë diellore në çatitë e objekteve. Përmes kombinimit të dhënave për kohën, si dhe për vendosjen dhe hijezimin e çatave të objekteve, aplikacioni bën përllogaritje për arsyetimin nga vendosja e paneleve diellore.



Fotografia 18 - Aplikacioni ZonAtlas

4.6. Franca

Institucionet të cilat janë pionierë në hapjen e të dhënave në Francë janë qytetet Ren dhe Paris, duke filluar me iniciativa për të dhënat e hapura që nga viti 2010. Portali për të dhënat e hapura të Parisit janë publikuar në fillim të vitit 2011, duke hapur të dhëna nga fusha të ndryshme lidhur me punën e qytetit dhe institucioneve të tija, ku pas një kohe të shkurtër janë përpunuar aplikacione interesante të ndryshme, siç janë harta me histori për rrugët në Paris, harta zgjedhore interaktive, ose aplikacioni për 70 lloje të ndryshme të druve në Paris (të dobishme për personat me alergji).

Misioni ndër-resor Etalab, e cili si organizatë është nën kabinetin e kryeministrit, e angazhuar për krijimin dhe mirëmbajtjen e **portalit qendror për të dhënat e hapura të Francës** data.gouv.fr, i cili është publikuar në dhjetor të vitit 2011. Versioni i ri i portalit është publikuar në dhjetor të vitit 2013.


4.6.1. Oficeri kryesor për të dhëna

Franca është vendi i parë evropian i cili në nivel nacional ka vendosur funksion të veçantë – oficeri kryesor për të dhëna (Chief Data Officer), i cili ka rol në përmirësimin e cilësisë së të dhënave të prodhuara në shtet, si dhe në ndarjen e të dhënave mes institucioneve, hulumtuesve, kompanive dhe qytetarëve. Lidhur me të dhënat e hapura, mund të shihet funksioni i tij lidhur me autoritetin për kërkimin e të dhënave nga institucionet shtetërore të cilët janë pronar të dhënave, që në këtë mënyrë të katalizohet involvimi i institucioneve publike në procesin e publikimit të dhënave të hapura.

4.6.2. Të dhëna të hapura të SNCF

SNCF – **hekurudha nationale e Francës** është në pronësi të shtetit dhe është përgjegjëse për mirëmbajtjen e shërbimeve hekurudhore nationale për transport të udhëtarëve dhe mallrave.

Duke pasur parasysh se SNCF çdo ditë transporton 10 milionë udhëtarë, në funksionimin e saj prodhohen dhe analizohen numër i madh të dhënash, të cilat përfshijnë orarin e trenave, kohën reale të arritjes dhe nisjes, pajisja dhe shërbimet e stacioneve, rregullshmëria e trenave, qasja në stacionet etj. Duke e parë mundësinë nga mënyrat inovative në pasurimin e shërbimeve elektronike lidhur me transportin hekurudhor, SNCF vendosi t'i hape të dhënat e saja dhe të tërheqë numër të madh të entuziastëve të cilët pozitivisht mund t'i shfrytëzojnë këto të dhëna. Të dhënat gjenden në **portalin e SNCF** data.sncf.com.



Fotografia 19 – Portali për të dhënat e hapura të SNCF

4.7. Austria

Në korrik të vitit 2011 është formuar **organizata për të dhëna të hapura qeveritare në Austri**, me qëllim që t'i vendos dhe t'i zbatojë politikat për të dhëna të hapura qeveritare. Anëtarët themeluesë janë qytetet Vjena, Linci, Salcburgu dhe Graci, si dhe Zyra Federale e Austrisë, e cila e udhëheq organizatën. Në bazë të punës së kësaj organizate, në fillim të themelimit, janë përpiluar parimet e të dhënave të hapura të Austrisë, modeli licencë për shfrytëzimin e të dhënave të hapura, standardet për portalin qendror për të dhënat e hapura dhe standardet për meta të dhënat. Edhe pse është formuar ekipi qendror për të dhënat e hapura, megjithatë është theksuar mundësia e përgjegjësisë së çdo komune që t'i grumbullojë dhe t'i publikojë të dhënat e hapura.

Austria bën përpjekje të mëdha në nivel regjional, gjegjësisht është inkuadruar në grupe pune me Gjermaninë dhe Zvicrën për harmonizimin e meta të dhënave të seteve të dhënave të cilat i publikojnë këto vende.

Edhe pse në Austri është arritur sukses i dukshëm në publikimin e të dhënave të hapura nga ana e komunave, megjithatë nuk ekziston standardizim dhe harmonizim i seteve të dhënave të cilat publikohen nga ana e komunave. Kjo e bën më të vogël vlerën krahasuese të dhënave, pasi që nevojitet përpjekje plotësuese nga ana e programerëve që t'i shfrytëzojnë të dhënat nga burime të ndryshme në nivel të Austrisë.

4.7.1. Modeli për implementimin e Qeverisë së Hapur

Koncept interesant i cili aplikohet në Austri është vendosja e të dhënave të hapura në bazë të **Modelit të definuar për implementimin e Qeverisë së Hapur**. Ky model është përpunuar nga ana e Qendrës për hulumtim në administratën publike KDZ Austri dhe Qyteti i Vjenës.

Modeli për implementimin e Qeverisë së Hapur tregon hap pas hapi qasjen e implementimit të iniciativave për Qeveri të Hapur, si dhe përfshinë indikatorë për matjen e suksesit të hapave individual.

Në këtë model implementues, të dhënat e hapura paraqesin fazën e parë prej katër fazave të definuara:

Faza 1 – Përmirësimi i transparencës së të dhënave: Hapja e qasjes deri te të dhënat nga sektori publik;

Faza 2 – Përmirësimi i pjesëmarrjes së hapur: Hapja e Qeverisë dhe administrimi për idetë dhe njohuritë e opinionit;

Faza 3 – Përmirësimi i bashkëpunimit të hapur: Përmirësimi i bashkëpunimit të hapur mes institucioneve, qytetarëve dhe opinionit, dhe ekonomisë;

Faza 4 – Mundësimi i inkuadrimin të tërësishëm: Mundësimi i inkuadrimin të opinionit përmes transparencës, pjesëmarrjes dhe bashkëpunimit.

Faza 1 fokusohet në dy sfida kryesore, identifikimi i të dhënave potenciale me vlerë të madhe dhe ndikim të madh, si dhe përmirësimi dhe sigurimi i cilësisë së të dhënave – saktësia, konsistenca dhe azhurnimi.

Aktivitetet në fazën 1 janë:

- Formimi i qendrës për të dhëna të hapura (pika qendrore për menaxhim me politika për të dhëna të hapura dhe ofrimi i mbështetjes)
- Krijimi i katalogut të seteve të dhënave
- Monitorimi i të dhënave interne
- Përmirësimi i cilësisë së të dhënave
- Krijimi i planit për publikim të dhënave
- Grumbullimi i meta të dhënave
- Krijimi i portalit për të dhëna të hapura.

Për fazën 1, ky model përfshinë edhe veglën për vlerësim të zgjedhjes së seteve të dhënave, të cilat me prioritet duhet të publikohen. Administrata bën evaluimin e të dhënave të veta interne përmes përdorimit të kriterëve që vijojnë për të cilat jep vlerësim:

- **Përkufizimet ligjore** – publikimi i të dhënave a i nënshtrohet kufizimeve ligjore;
- **Mbrojtja e të drejtave personale dhe korporative** – të dhënat a i përfshijnë të dhënat personale ose të dhënat për të cila ka të drejta korporative;
- **Të drejtat e autorit** – të dhënat a janë tërësisht në pronësi të institucionit i cili ka për qëllim t'i publikojë;
- **Vlera** – Cila është vlera për publikimin e të dhënave për subjektet e interesuara;
- **Përpjekja** – Sa është përpjekja që duhet të investohet për publikimin e të dhënave;
- **Cilësia e të dhënave** – Sa është cilësia e të dhënave;
- **Qasja teknike** – Të dhënat a janë të kapshme në formatin e hapur;
- **Sinergjia** – Institucioni tashmë a i siguron të dhënat / shërbimet për qëllime tjera.

4.7.2. Portali për të hëna të hapura të Vjenës

Portali për të dhëna të hapura i Austrisë data.gv.at është publikuar në vitin 2011, si pionier i portalit për të dhëna të hapura nga regjioni gjerman folës. Portali qendror lidhur me portalet e komunave në Austri prej ku merren të dhënat për setet e të dhënave të publikuara. Njëkohësisht, portali qendror i Austrisë është i lidhur me portalin qendror të BE për të dhëna të hapura për shkak të prezantimit të seteve të dhënave të hapura nga Austria.

Portali për të dhëna të hapura i Vjenës open.wien.gv.at, posedon më shumë se 300 sete të dhënash, në bazë të cilave janë përpunuar më shumë se 190 aplikacione dhe vizuelizime. Setet e të dhënave publikohen në faza, gjegjësisht në bazë periodike stimulohet hapja e të dhënave nga ana e administratës qendrore në Vjenë.

Për portalin përdoret licenca **Creative Commons CC 3.0 BY**, sipas të cilit të dhënat mund të shfrytëzohen pa pagesë, lirisht, të shfrytëzohen dhe të ri-distribuheshin, por vetëm gjatë shfrytëzimit duhet të ceket emri i pronarit të dhënave.



Fotografia 20 – Portali për të dhënat e hapura të Vjenës

4.7.3. Harta e toaleteve të Vjenës

Aplikacioni për harta e toaleteve të Vjenës, mundëson vendndodhjen e toaleteve publike në territorin e Vjenës, gjegjësisht vendndodhjen e toaletit më të afërt publik nga pozita e shfrytëzuesit. Po ashtu aplikacioni i markon ato toalete të cilat janë të kapshëm për personat me invaliditet.



Fotografia 21 –Harta e toaleteve e Vjenës

4.7.4. Parkingu në Vjenë


Përmes aplikacionit për parking në Vjenë, shfrytëzuesi mund t'i fitojë lokacionet e të gjitha parkingjeve publike në Vjenë, duke përfshirë edhe të dhënat për atë nëse ato janë pa pagesë ose nëse paguhen. Po ashtu, në bazë të dhënave për atë kur paguhet parkingu, si dhe nëse në parking ka vende të lira, shfrytëzuesi mund të shohë se cilin parking e ka më afër dhe cili parking është i lirë. Gjithashtu, parkingu mund të paguhet drejtpërdrejt përmes aplikacionit.



Fotografia 22 – Parkimi në Vjenë

4.7.5. Buxheti i hapur

Ueb portali www.offenerhaushalt.at i prezanton **financat e komunave në Austri**. Portali është përpunuar nga ana e Qendrës për hulumtim në administratën publike KDZ Austri, në bazë të dhënave të fituara nga komunat për buxhetin e planifikuar dhe të realizuar sipas zërave. Krahas seteve të dhënave të kapshme, në portal krijohen vizuelizime të ndryshme për komunën e zgjedhur, duke përfshirë vizuelizim si është planifikuar buxheti, në cilat fusha shpenzohet buxheti i komunës.



Fotografia 23 – Portali për buxhet të hapur i Austrisë

5. Përfundim - rekomandime

Duke i parë metodat e ndryshme të implementimit të politikave për të dhënat e hapura në vendet në BE, mund të vërehet se nuk ekziston qasje standarde në realizimin e tyre. Megjithatë, nga analiza mund të nxirren më shumë rekomandime të cilat mund të aplikohen në implementimin e të dhënave të hapura në nivel qendror dhe lokal..

Standardet për të dhënat dhe meta të dhënat

Për shkak të shfrytëzimit më të thjeshtë dhe më efikas të seteve të dhënave të institucioneve të ndryshme, nevojitet të vendosen standarde për formatin e të dhënave, strukturën dhe semantikën e të dhënave.

Krahas standardeve për cilësi e të dhënave, me rëndësi të veçantë është vendosja e standardit për meta të dhënat, gjegjësisht të dhëna përshkuese të seteve të dhënave. Është e rëndësishme që standardi për meta të dhënat të harmonizohet me standardin për përshkrimin e seteve të dhënave në Evropë DCAT-AP (DCAT Application profile for data portals in Europe), me qëllim setet e hapura të dhënave nga vendi të grumbullohen ("harvestohen") edhe nga portali qendror për të dhëna të hapura të BE-së.

Standardizimi i seteve të dhënave është një nga masat më kyçe lidhur me politikën për të dhëna të hapura në njësitë e vetëqeverisjes lokale në vend, pasi që në këtë mënyrë do të mundësohet harmonizimi i seteve të dhënave nga komuna të ndryshme. Nëse komunat publikojnë të dhëna të hapura me strukturë të njëjtë, sipas formatit të definuar, shfrytëzuesit do ta kenë më thjeshtë që t'i kombinojnë dhe t'i shfrytëzojnë të dhënat e përbashkëta e të gjitha komunave.

Korniza ligjore për publikimin e të dhënave të hapura nga komunat

Në pajtim me Ligjin për shfrytëzimin e të dhënave nga sektori publik ("Gazeta zyrtare e RM" nr.27/2014) caktohen obligimet e organeve dhe institucioneve nga sektori publik për shpalljen publike të dhënave, të cilat krijohen në realizimin e kompetencave të veta në pajtim me ligjin, me qëllim që të mundësohet shfrytëzimi i të gjitha të dhënave nga ana e personave fizik dhe juridik për krijimin e informatave të reja, përmbajtjeve, aplikacioneve ose shërbimeve, dhe atë në format të dhënave të hapura në pajtim me mundësitë teknike të institucioneve.

Megjithatë, nevojitet të definohet obligimi i saktë i institucioneve, më saktë i njëjësive të vetëqeverisjes lokale në këtë rast, për atë se cilat të dhëna duhet të publikohen, kur të publikohen dhe në çfarë strukture. Me caktimin e obligimit të tillë me kornizë

të caktuar ligjore, duke përfshirë akte nënligjore ose vendimin e caktuar, do të mundësohet publikimi i harmonizuar dhe konsistent i të dhënave të hapura nga ana e njësive të vetëqeverisjes lokale.

Krijimi dhe zhvillimi i pikës qendrore për të dhëna të hapura në vend

Për shkak të menaxhimit më efikas dhe më efektiv me politikat për të dhëna të hapura në vend, është e dëshirueshme që të krijohet pika qendrore për të dhënat e hapura. Për momentin ekziston ekip në Ministrinë për Shoqëri Informatike dhe Administratë, që punon (mes tjerash) me të dhënat e hapura, gjegjësisht në portalin qendror për të dhëna të hapura, por megjithatë duhet të formohet njësi e posaçme organizative e cila do të jetë përgjegjëse vetëm për problematikën e të dhënave të hapura. Kjo njësi organizative duhet ta promovojë këtë fushë, të jetë ciceron në “presionin” mbi institucionet shtetërore që t’i publikojnë të dhënat e hapura, por edhe të jetë mbështetje e institucioneve të cilat planifikojnë publikimin e të dhënave në format të hapur. Po ashtu, kjo njësi organizative duhet të jetë “ambasador” për përfitimet në vendosjen e të dhënave të hapura, duke organizuar ngjarje të ndryshme promovuese.

Model për implementimin e Qeveri e hapur

Ngjashëm me modelin austriak, duhet të krijohet model për implementimin e Qeverisë së hapur ose, ta përshtatë atë ekzistuesin), për shkak të implementimit më efikas dhe më të organizuar të iniciativave të këtylla.

Në këtë kontekst, fokusi duhet të vihet mbi publikimin e sa më tepër sete të dhënash në formë kuantitative, por kryesisht publikimi i atyre seteve të dhënave të cilat janë me interes të veçantë. Në prioritetizimin e këtyllë, e rëndësishme është të involvohen palët e prekura, gjegjësisht të konsultohen përfaqësuesit e sektorit civil si dhe përfaqësuesit e bashkësisë së biznesit të cilët do të kishin dobi prej këtyre të dhënave.

Aktivite promovuese

Krahas asaj se Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë ka organizuar disa ngjarje, në të cilat promovohet koncepti dhe përfitimet nga të dhënat e hapura, megjithatë duhet të intensifikohen këto aktivitete në qasje të planifikuara dhe të përhershme.

Me hapjen e vazhdueshme të seteve të dhënave, në bazë të vazhdueshme duhet të mbahen gara “hekaton”, ku do të marrin pjesë qytetarë të interesuar – studentë, “freelancer”, përfaqësues të bashkësisë së biznesit dhe të sektorit civil. Në këto gara do të mbahet konkursi për aplikacione më të mira të cilat i shfrytëzojnë të dhënat e hapura të publikuara.

Po ashtu, me rëndësi të veçantë është edhe organizimi i fushatave për informimin e opinionit të gjerë për përfitimet nga vendosja e të dhënave të hapura, si dhe për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve, si dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.

Vizuelizimi i të dhënave të hapura

Më tepër shembuj të cilët janë përmendur në analizë tregojnë se krahas asaj që komunat në vendet e BE-së i publikojnë të dhënat e veta në format të hapur, në portalet e tyre për të dhëna të hapura, ata po ashtu edhe mundësojnë vegla për vizuelizim të dhënave të caktuara. Këto të dhëna mund të jenë nga fusha e financave, ose nga fusha e turizmit ose mjedisit jetësor, por koncepti është se vizuelizohen ato të dhëna për të cilat ka interes të veçantë publik. Sipas kësaj, veçanërisht qasje interesante dhe të rëndësishme do të ishte nëse komunat ofrojnë vegla të tilla për vizuelizim të ueb faqeve të tyre, ose të një faqe të centralizuar duke i bashkuar të dhënat nga të gjitha komunat në vend.

Roli i pikave rajonale për mbështetje të komunave në grumbullimin dhe publikimin e të dhënave të hapura

Disa nga vendet në BE i shfrytëzojnë kapacitetet e administratave regjionale, ose të organizatave regjionale të cilat i bashkojnë më tepër komuna, që t'i japin përkrahje komunave më të vogla, gjegjësisht komunave me resurse më të vogla, në procesin e grumbullimit dhe publikimit të dhënave të hapura. Qasja regjionale në publikimin e të dhënave mundëson vlerë më të madhe të dhënave të publikuara, pasi që grumbullohen të dhënat prej një pjese më të madhe, në këtë mënyrë duke siguruar më shumë dobi për shfrytëzuesit.

Nevojitet të shqyrtohet mundësia e mbështetjes të këtyllë të dhënë nga ana e Bashkësisë së Njësove të Vetëqeverisjes Lokale (BNJVL), si dhe nga qendrat për zhvillim regjional në vend.

Në pajtim me analizën e bërë, mund të konstatohet se në vendin tonë ka avancim të caktuar në vendosjen e kornizës ligjore, organizative dhe teknike për të dhënat e hapura, por kjo ka të bëjë më shumë në nivelin qendror, se sa në nivelin lokal. Duke marrë parasysh rëndësinë e punës së njësisë të vetëqeverisjes lokale për qytetarët, përfitimet nga publikimi i të dhënave të hapura nga ana e tyre do të ishin më të mëdha.

6. Literatura e shfrytëzuar

- Global Open Data Index, <http://index.okfn.org/>
- European Data Portal <http://www.europeandataportal.eu/>
- <http://ckan.org/about/>
- Data Catalog Vocabulary (DCAT), W3C Recommendation 16 January 2014: <https://www.w3.org/TR/vocab-dcat/>
- https://joinup.ec.europa.eu/asset/dcat_application_profile/description
- Directive 2007/2/EC of the European Parliament and of the Council of 14 March 2007 establishing an Infrastructure for Spatial Information in the European Community (INSPIRE)
- COMMISSION REGULATION (EC) No 1205/2008 of 3 December 2008 implementing Directive 2007/2/EC of the European Parliament and of the Council as regards metadata
- Open Data Institute: Open data roadmap for the UK, 2015
- <http://data.gov.uk>
- Protection of Freedoms Act 2012, Parliament of the United Kingdom
- Код за транспарентност на локалните самоуправи (Local Government Transparency Code) Local Government Transparency Code 2015, Department for Communities and Local Government, February 2015
- Case Study: Bristol City Council: Bringing open data to life, Local Government Association
- Case Study: London Borough of Redbridge Council: open data, Local Government Association
- <http://data.redbridge.gov.uk/>
- Case Study: Leeds Data Mill, Local Government Association, November 2015
- <http://leedsdatamill.org/>
- Case Study: Norfolk County Council enhanced data spend, Local Government Association, January 2016
- Open Data Institute: Open data roadmap for the UK, 2015
- <http://spendnetwork.github.io/>
- Case Study: North Somerset customer information portal and historic tourism data, Local Government Association, November 2015

- <http://discovernorthsomerset.co.uk/>
- <http://www.epsiplatform.eu/content/denmark-goes-open-data-big-time#sthash.hYf658JU.dpuf>
- <http://data.kk.dk/>
- <http://www.odaa.dk>
- <http://genbrug.smartaarhus.dk/>
- <http://stiften.dk/trafikkort>
- <http://www.citylab.com/tech/2014/04/how-helsinki-mashed-open-data-regionalism/8994/>
- <http://vm.fi/open-data-programme>
- <http://dev.hel.fi/apis/openahjo/>
- <http://blindsquare.com/>
- <https://www.avoindata.fi/fi>
- <https://data.overheid.nl/>
- <http://www.10000scholen.nl>
- <https://www.waternet.nl/themas/vaarwater>
- <http://www.omgevingsalert.nl/app/>
- <http://www.zonatlas.nl/home/>
- <https://data.sncf.com/>
- <http://data.gv.at/>
- <http://open.wien.gv.at/>
- <http://www.offenerhaushalt.at/>
- Johann Höchtel, Brigitte Lutz, Stefan Pawel: Open Government Data Austria - Organisation, Procedures and Uptake;
- Bernhard Krabina, Thomas Prorok, Brigitte Lutz: Open Government Implementation Model Version 2.0, KDZ Centre for Public Administration Research, Vienna; City of Vienna, Chief Executive Office

PËR AUTORIN:

Martin Todevski ka diplomuar në Departamentin e e-Biznesit në Fakultetin Ekonomik në Shkup, ndërsa ka magjistruar departamentin për Menaxhment të proekteve në Fakultetin e Elektronikës dhe Teknologjive e informatike në Shkup. Ai ka përvojë disavjeçare në fushën e reformave të administratës publike dhe e-qeverisjes, është autor i disa punimeve shkencore që lidhen me këto fusha, të cilat janë botuar në publikime dhe konferenca ndërkombëtare.